**AKT THEMELIM**
**I(KONTRATE)**

**PER THEMELIMIN E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**" ILVA-ELEKTRIK "**

Mbi bazen e nje marreveshje paraprake, ne Tirane,sot me daten _______/2000, lidhet kjo kontrate , Akt Themelimi, ndermjet :

Z.PETRIT PEQINI, biri Xhelalit,dtl.28.11.1950,banues ne Tirane,Rr.Myslym Shyri,Pallati 1,shk.13,ap.198, me leter njoftimi EV Nr.218719
ZJ.VANJA PEQINI,e bija Kolit,e dtl.15.02.1953, banuese ne Tirane,ne adresen e mesiperme,me pashaporte nr.0423824.

Bazuar ne Ligjin Nr.7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare", te Ligjit Nr.7667 date 28.01.1993 "Per Regjistrin Tregtar", si dhe ne dispozitat e tjera ligjore ne fuqi,si Kodi Civil, etj., palet e mesiperme kane rene dakort qe te krijojne nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, mbeshtetur ne principet e meposhteme:

Neni 1
Te themelejone nje "Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar" per ushtrim veprimtarie private, shoqeri te cilen do ta emertojne "ILVA-ELEKTRIK".

Neni 2
Shoqeria ka statusin e personit juridike dhe selia e saj ndodhet ne Tirane,Rr."M.Gjollesha",pallati 32,shk.2,kati I-re.

Neni 3
Veprimtaria e shoqerise, marredheniet qe lindin nga kjo kontrate, si dhe marredheniet e saj me persona te tjere juridik e fizik, vendas apo te huaj, rregullohen sipas dispozitave te kesaj kontrate, statutit te shoqerise qe I bashkalidhet kesaj kontrate(Akt Themelimit), Ligjit Nr.7638 date 19.11.1992, Ligjit Nr.7667 date 28.01.1993.

Neni 4
Shoqeria pergjigjet vetem me pasurine e saj. Ajo, shoqeria, nuk pergjigjet per detyrimet e ortakve te saj, qe atra mund te marrin persiper si persona fizik apo edhe tej veprimtarise se kesaj shoqerie, veprimtari e cila parashikohet nga kjo kontrate(akt themelimi) dhe statuti bashkalidhur ketij akti. Po keshtu, edhe ortaket nuk pergjigjen personalisht per detyrimet dhe humbjet e Shoqerise, tej kontributit te tyre,pjesmarrjes, ne kapitalin themeltar te shoqerise(kuotes se kapitalit te vene prej tyre).

Neni 5
Shoqeria ka si objekt te veprimtarise saj ate te import eksportit, tregtimin me shumice dhe pakice te te gjitha artikujve industriale,kabllove,televa(baker,alumin)elektrike,pajisjeve elektrike,ushqimore, bujqesore, blegtorale, konfesksioneve, duhane, cigare, pajisjeve elektroshtepiake, pjeseve te kembinmit per çdo lloj mjeti motorrik, servise automjetesh,punimin ne sistemin e sinjalizimeve dhe elektrike,centralieve hidraulike dhe atyre

V.Peqini Vanja Peqini

termike,impiante per prodhim energjie alternative,impiante elektrike per nenstacionet,kabinat dhe transformatore,impiante dhe linja elektrike,telefoni,radiotelefoni,televiziv,citefoni dhe mirembajtja e tyre,linja te T.U. e T.U. e te mesem,aparatura elektrike dhe mbirembajtja e tyre,transformatore,panele,kuadro,etj.,punime kolaudimi per pajisjet primare dhe sekondare dhe per kolaudime mekanike per nenstacionet dhe centralet elektrike,projektim elektrik,projektim rrjeteve telefonike,radiotelefoni,citefoni,sistem alarmi,televiziv per godina civile,industriale,turistike,bujqesore,projektim impianteve te prodhimit dhe shpmdarjes se energjise,rikonstruksione elektromekanike,servis per elektromotore,transformatore dhe te gjithave pajisjeve elektrike,pastrim dhe perpunim vaji,montim kabina elektrike,prodhim elektromotore,transformatore dhe te gjitha pajisjeve te ndryshme elektrike,servis per T.V.dhe kompjutera,riparimin e impjanteve dhe rrjetit elektrik,kontroll laboratorik per materialet elektrike dhe atyre te ndertimit,instalimi impianteve dhe makinerieve ngritese e transportuese, komisionari, konsulenca juridike dhe ekonomike,etj.

Neni 6

Veprimtaria e shoqerise, emertimi, selia e saj, te percaktuar ne kete akt themelimi, pa pelqimin e paleve te mesiperme, ortakeve, nuk mund te ndryshojne.

Neni 7

Kapitali themeltar I shoqerise eshte 100.000 leke.

Kontributi I ortakeve ne kete kapital themeltar eshte si me poshte :

1. Petrit Peqini 50 perqind
2. Vanja peqini 50 perqind

Ky kapital, eshte I nenshkrueshem teresisht dhe I shlyeshem krejtesisht nga ana e ortakeve. Kuotat e kapitalit te ortakve dhe mjetet e kapitalit themeltar te shoqerise, do te shenohen ne librin e llogarise se kesaj shoqerie, e cila ka llogarine e saj rrjedhese ne nje nga bankat e Shqiperise.

Ne librin e llogarise se shoqerise krijohet "Fondi Themeltar I Ortakeve", ku shenohen kapitalet e vena nga sejcila ortak. Ortaket nuk kufizohen ne rritjen e kontributit te tyre ne kete kapital themeltar te shoqerise.

Neni 8

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise do te jete 10 vjet, perjashto ketu rastin per ndonje zgjidhje te parakoheshme.

Neni 9

Fitimi I realizuar nga shoqeria, gjate ushtrimit te veprimtarise se saj, pas shlyerjes se detyrimeve ligjore dhe zbritjes se fondeve te tjera, ndahet midis ortakeve, ne perputhje me pjesmarrjen e tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 10

Organet e shoqerise jane :

1. Asambleja e Ortakeve ;
2. Administratori I Pergjitheshem, qe aktualisht do te jete Vanja Peqini
3. Komisioni Revizionimit ose I Eksperteve Kontabel.

Vanja Peqini

Modalitetet e formimit dhe te funksionimit te tyre, percaktohen ne Statuin e Shoqerise.

Neni 11
Ortaket detyrohen te ruajne karakterin sekret te dokumentacionit,informatave, njohurive dhe pervojes se shkembyer ose te realizuar ne kuadrin e shoqerise, dhe marrin te gjitha masat e nevojshme per shmangjen e perhapjes se tyre, qofte edhe pjeserisht. Ortaket pergjigjen per te gjitha pasojat e demshme te nje shkelje te mundeshme te ketij detyrimi kur kjo shkelje eshte rrjedhim I ndonje veprimi te qellimta apo nga pakujdesia.

Neni 12
Mosmarreveshjet qe mund te lindin midis ortakeve , ne rast se nuk do te arrihet te zgjidhen me mirekuptim, kompetente per zgjidhjen e tyre do te jete Gjykata e Rrethit Tirane.

Neni 13
Dispozita me te hollesishme per shoqerine, percaktohen ne Statutin e saj bashkalidhur ketij Akti Themelimi.

**ORTAKET**

Petrit Peqini **PETRIT PEQINI – VANJA PEQINI** Vanja Peqini

NOTERE
ENKELEIDA HOXHA
Tiranë Tel 713 26

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr. 905 Rep.
Nr. 101 Kol.

VERTETIM

Vertetohet se sot me daten 24.03/2000, para meje noterit E. Hoxha, noter ne kete qytet, u paraqiten personalisht Petrit Peqini dhe Vanja Peqini, per identitetin e te cileve u siogurova nga pashaportat e tyre personale, te cilet me deklaruan se sa me siper eshte nje akt themelimi I Shoqerise " ILVA-ELEKTRIK"shpk Tirane, e hartuar me vullnetin e tyre te lire e te plote dhe e nenshkruan ate rregullisht si dhe une e vertetoj konform ligjit.

NOTERI

NOTERE
ENKELEIDA HOXHA
Tiranë Tel 713 26

# STATUTI

# SHOQERISE " ILVA-ELEKTRIK" SHPK

Ne baze te Aktit te Themelimit, ne te cilin shprehet vullneti I ortakve Petrit Peqini dhe Vanja Peqini, per krijimin e Shoqeise "ILVA-ELEKTRIK "shpk , si dhe ne mbeshtetje te Ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare", dhe te Ligjit Nr.7667 date 28.01.1993 "Per Regjistrin Tregtar ", perpilohet ky statut, ne baze te dispozitave te te cilit do te organizohet dhe drejtrohet veprimtaria e Shoqerise.

## KREU I PARE

## DISPOZITA TE PERGJITHESHME
( Forma, emertimi, objekti, selia,kohezgjatja)

### Neni 1

Parimet dhe normat e ketij statuti, jane formuluar ne baze te vullnetit te ortakeve, pjesmarres ne Aktin e Themelimit, Ligjit "Per Shoqerite Tregtare", Ligjit "Per Regjistrin Tregtar", te cilet kane krijuar kete Shoqeri Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar.

Ky statut, rregullon poziten juridike te ortakeve dhe te punonjesve te shoqerise, te dhenat me rendesi per qarkullimin juridik, organizimin, objektin e veprimtarise dhe çeshtje te tjera me rendesi per punen e shoqerise.

Shoqeria fiton personalitetin e saj juridik me regjistrin e saj ne Gjykaten e Rrethit Tirane dhe ne Regjistrin Tregtar te kesaj Gjykate.

### Neni 2

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar do te emertohet "ILVA-ELEKTRIK shpk".

Shoqeria " ILVA-ELEKTRIK " shpk do te kete per objekt te veprimtarise se saj :import eksportin,tregtimin me shumice dhe me pakice te te gjithe artikujve industriale,kabllove,telave(baker,alumin)elektrike,pajisjeve,elektrike,ushqimore, bujqesore, blegtorale, duhane, cigare, konfeksioneve, pjeseve te kembimit per te gjitha mjetet motorike, makineri e pajisje, servis automjetesh,punime ne sistemin e sinjalizimeve dhe elektrike, centraleve hidraulike,centrale termike,impiante per prodhim energjie alternative,impiante elektrike per nenstacionet,kabinat e transformatore,impiante dhe linjaelektrike, telefoni,radiotelefoni, televiziv,citefoni dhe mirembajtja e tyre,linja T.L. e T.U.e te mesem,aparatura elektrike dhe mirembajtja e tyretransformatore,panele,kuadro,etj.,punime kolaudimi per pajisjet primare e sekondare dhe per kolaudime mekanike per nenstacionet dhe centralet elektrike,projektim elektrik,projektim rrjeteve telefonike,radiotelefoni,citofoni,sistem

Vanja Peqini

elektrike,projektim elektrik,projektim rrjeteve telefonike,radiotelefoni,citofoni,sisteme alarmi,televiziv,per godina civile,industriale,turistike,bujqesore,projektim impianteve te prodhimit te shperndarjes se energjise,rikonstruksione elektromekanike,servis per elektromotore,transformatore dhe te gjithave pajisjeve elektrike,pastrim dhe perpunim vaji,montim kabina elektrike,prodhim elektromoteresh,transformatoresh dhe pajisjeve te ndryshme elektrike,servis per T.V. dhe kompjutera,riparimin e impjanteve dhe rrjetit elektrik,kontroll laboratorik I materialeve elektrike dhe te atyre te ndertimit,instalimi impainteve dhe makinerive ngritese e transportuese,komisionari, konsulence juridike dhe ekonomike,etj.

Me vendim te Asamblese se Ortakeve, objekti I veprimtarise se shoqerise mund te shtohet ose pakesohet.

Neni 3

Selia e Shoqerise do te jete ne Tirane,Rr.M.Gjollesha ",pallati 32,shk.2,kati I-re.

Shoqeria ka te drejte te hapi filiale, dege, apo perfaqesi dhe te japi perfaqesim ne te gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise si dhe jashte saj, ne perputhje me legjislacionin e vendit ku ato hapen.

Ndryshimi I selise se shoqerise, si dhe filialeve apo zyreve te perfaqesive te saj, vendoset me vendim te Asamblese se Ortakeve.

Neni 4

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise do te jete 10 vjet. Ky afat mund te zgjatet ose zvogelohet, vetem me vendim te Asamblese se Ortakeve.

## KREU I DYTE

## KAPITALI THHEMELOR

Neni 5

Kapitali themelor I shoqerise eshte 100.000 leke.

Ky kapital eshte investuar teresisht nga te dy ortaket dhe eshte I ndare si me poshte :

VANJA PEQINI 50 perqind

PETRIT PEQINI 50 perqind

Pjesmarrsit ne kapitalin themelor te Shoqerise, ruajne te drejten e tyre te pronesise ne kete shoqeri.

Shoqeria mund te zmadhoje ose zvogeloje kapitalin e saj,por po qe kjo e fundit, ortaket duhet te marrin masa per ndryshimin e formes se shqoerise.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te trnasferueshme ndermjet ortakve,ne rruge trashigimie, ose ne rast ndarje pasurore ndermjet bashkashorteve. Ne te njejten kohe çdo ortak ka te drejte qe ti trasferoje kuotat qe ai zoteron ne kapitalin themelor te shoqerise, por me para duhet te njoftoje me shkrim ortakun tjeter , I cili ka te drejten e parablerjes se ketyre kuotave. Ne rast se brenda 30 diteve ortaku, qe I ofrohet per blerjen e atyre kuotave te kapitalit, nuk njofton me shkrim ortakun qe ofron keto kuota per shitje, ky I fundit eshte I lire qe tia shesi nje apo me shume personave te

Vanja Peqini

trete kote kuota, por asnjehere me kushte me favorizuese se ato te propozuara ortakut tjeter.

Heqja dore nga shoqeria si ortak, nuk e liron ortakun nga detyrimet e marra me para ndaj shoqerise dhe nuk pezullon detyrimet e shoqerise ndaj ortakut qe largohet prej saj.

Neni 6

Pjesmarrja ne shoqeri, nuk I pengon ortaket te kene pavaresi ligjore, organizative dhe te drejta te tjera pronesie, jashte shoqerise. Ortaket qe marrin pjese ne shoqeri, nuk nuk I nenshtrohen asaj si person. Ata nuk pergjigjen per detyrimet qe rrjedhin nga veprimtaria ekonomike tregtare e shoqerise, tej kapitalit qe ata kane kontribuar per krijimin dhe funksionimin e saj. Po keshtu edhe shoqeria nuk pergjigjet per detyrimet e ortakeve te saj jashte kesaj veprimtarie.

Neni 8

Cdo ortak ka te drejte te marri pjese e te kerkoje te dhena mbi administrimin e veprimtarise ekonomike tregtare te shoqerise dhe mbi rezultatet e saj, te beje propozime ne kete drejtim per shqyrtim ne Asamblene e Ortakeve,ne perputhje me kete Statut dhe Aktit te Themelimit.

Neni 9

Ortaket jane te detyruar qe te depozitojne kuotat e tyre dhe kuotat eventuale suplementare, te marrin pjese ne administrimin e shoqerise, te japin informacione te ndryshme ne interes te veprimtarise se shoqerise, te realizojne sherbime per kete qellim, gjithmone ne perputhje me kete statut dhe aktit te themelimit.

Neni 10

Shoqeria percakton Fondin Themelor dhe Fondin Rezerve. Gjate ushtrimit te veprimtarise se saj, ajo mund te percaktoje edhe fonde te tjera.

Fondi themelor I shoqerise formohet nga mjetet e investuara nga ortaket dhe shfrytezohet nga shoqeria per realizimin e veprimtarise se saj, si dhe per te mbuluar rreziqet pas shfrytezimit te fondit rezerve.

Perberja, shuma e pergjitheshme, burimet per krijimin e fondit rezerve, perdorimi dhe rregullimi I çdo fondi te veçante, kryehet nga ana e administratorit te pergjitheshem.Detyrimet eventuale qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise mbulohen nga fondi rezerve dhe nga fonde te tjera, ose edhe nga shumat eventuale suplementare qe mund te derdhin ortaket kur keto detyrimi nuk mund te mbulhen nga fondet ekzistuese.

Neni 11

Shoqeria eshte pronare per ato sende per te cilat gezon te drejten e pronesise dhe per te tjera sende qe lidhen me permbusghjen e qellimit dhe te veprimtarise se saj. Shoqeria mund te bleje ose shfrytezoje edhe te drejta te tjera materiale duke perfshire ketu edhe te drejten per te ofruar pasurite e saja.

Vanja Pegini

Neni 12

Fitmi I realizuar gjate ushtrimit te veprimtarise se shoqerise, do te ndahet ndermjet ortakve ne perputhje me kontributin e tyre ne kapitalin themelor te shoqerise, sipas pershkrimit qe eshte bere ne kete statut dhe ne aktin e themelimit.

Neni 13

Rrezikun e humbjeve eventuale ne afarizmin e shoqerise, e bartin ortaket, ne perpjestim me mjetet e investuara per themelimin e shoqerise. Humbjet kompesohen nga e tere pasuria e shoqerise.Ne rast se humbja eshte shkaktuar per fajin ekskluziv te njerit prej aortakeve, atehere ky I fundit eshte I detyruar te kompesoje demin me mjetet e tija private.

KREU III

ORGANET E SHOQERISE

Neni 14

Organet e shoqerise jane :

ASAMBLEJA E ORTAKEVE
ADMINISTRATORI PERGJITHESHEM- aktualisht do te jete Vanja Peqini.
KOMISIONI I EKSPERTEVE KONTABEL – REVIZIONIMIT

Asambleja e Ortakeve eshte organi vendimor I shoqerise dhe perbehet nga ortaket e shoqerise. Ortaket realizojne te drejtat e tyre nepermjet vendimeve te mara nga Asambleja e Ortakeve, asamble e cila mblidhet te pakten nje here ne 6 muaj. Asambleja e ortakeve percakton drejtimet kryesore te veprimtarise se shoqerise, vendos per bilancin vjetor, per ndryshimet ne statut,per shtimin apo zvogelimin e kapitalit themelor te shoqerise.

Eshte I domosdoshem unanimiteti I vendimeve te Asamblese se Ortakeve per rastet e shtimit apo te zvogelimit te kapitalit themelor, per zgjatjen e kohes apo te pushimit te veprimtarise se shoqerise.

Neni 15

Shoqeria administrohet nga Administratori I saj I Pergjitheshem, I cili zgjidhet nga Asambleja e Ortakeve.

Administratori I Pergjitheshem perfaqeson shoqerine ne marredheniet me te tretet, te lidhi kontrate te ndryshme, te perfaqeosje shoqerine prane organeve administrative dhe organeve gjyqsore te te gjitha shkalleve, ka te drejten e emerimit te nje apo disa avokateve per mbrojtjen e interesave te shoqerise para te gjitha organeve te pushtetit,te punesoje e te largoje nga puna punonjes te ndryshem,duke lidhur me kete rast edhe kontratat individuale te punes.

Neni 16

Vanja Peqini
V Peqini

Per te kontrolluar veprimtarine financiare dhe ate ekonomike tregtare te shoqerise dhe te filialeve te mundeshme te saj, krijohet Komisioni Revizionimit, ose I eksperteve kontabel. Ky komision perbehet nga nje kryetar dhe nga nje ose me shume revizore, ose eksperte kontabel. Kryetari dhe anetaret e tjere te komisionit nuk duhet te jene punonjes te shoqerise apo te filialeve te saj. Ky komision eshte pergjegjes per veprimtarine e tija para administratorit dhe pergjigjet duke paraqitur raportin me shkrin per kontrollet e kryera.

Neni 17

Shoqeria pushon veprimtarine e saj ne çdo kohe qe vendos Asambleja e Ortakeve. Kur vendoset pushimi I veprimtarise se shoqerise,Asambleja e ortakeve emron komisionin e likujdimit , I cili I paraqet Asamblese se Ortakeve rapotin e likujdimit.Shoqeria pushon veprimtarin e saj kur Asambleja e Ortakeve miraton bilancin e likujdimit.Mjetet financiare te fituara si rezultat I veprimtarise se shoqerise,si dhe fondeve te tjera te shoqerise, ndahen ndermjet ortakeve ne formen e dividentit, ne perpjestim me kontributin e sejcilit ortak ne kapitalin themelor te shoqerise, pasi te jene bere me pare pagesat e kreditoreve.

Kur shoqeria pushon veprimtarise e saj, pasi shlyen te gjitha detyrimet qe ka, pjesa e mbetur e kapitalit ose e te ardhurave, ua ndan ortakve ne perpjestim me kuoten e dhene nga sejcili ortak per krijimin e kapitalit themelor.

ORTAKET

Vanja Peqini VANJA PEQINI – PETRIT PEQINI Petrit Peqini

NOTERE
ENKELEIDA HOXHA
Tiranë Tel 713 26

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr. 706 Rep.
Nr. 102 Kol.

VERTETIM

Vertetohet se sot me daten 29.03 /2000, para meje noterit E. Hoxha noter ne kete qytet, u paraqiten personalisht Vanja Peqini dhe Petrit Peqini, per identitetin e te cileve u sigurova nga pashaportat e tyre personale,respektivisht pashaporte nr.0423824 dhe leternjoftimi EV Nr.218719, te cilet me deklaruan se sa me siper eshte nje akt themelimi I Shoqerise " Ilva-Elektrik "shpk Tirane, e hartuar me vullnetin e tyre te lire e te plote dhe e nenshkruan ate rregullisht si dhe une e vertetoj konform ligjit.

NOTERI
NOTERE
ENKELEIDA HOXHA
Tiranë Tel 713 26